

## GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës:                   **PAKR 474/14**

Më:                                   **14 janar 2016**

### *NË EMËR TË POPULLIT*

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare dhe gjyqtare raportuese dhe gjyqtarët kosovarë të Gjykatës së Apelit Driton Muharremi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë të kolegjit, në pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Anne-Gaëlle Denier, si procesmbajtëse,

Në procedurën penale kundër të pandehurit

**G.G.**, emri i të atit [...], i lindur më [...] në [...], i cili para se të vendoset në paraburgim ka banuar në fshatin [...], shtetas i Kosovës, në paraburgim nga data 19 shtator 2014;

I akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë themelore të Mitrovicës nr. PP. 10/14, të ngritur më 14 nëntor 2014, me shpjegimin e parashtruar më 8 dhjetor 2014, për veprën **vrasje e rëndë**, në kundërshtim me nenin 179 (1.5) dhe (1.8) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej në tekst “KPRK”), lidhur me nenin 31 të KPRK-së;

I gjykuar në shkallë të parë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës me aktgjykimin P. nr. 132/14, të datës 30 korrik 2015 si më poshtë:

**G.G.** është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale **vrasje e rëndë**, në kundërshtim me nenin 179 (1.5) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Trupi gjykues e ka konstatuar të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më datën 22 mars 2013, në rrugën [...] në [...], i pandehuri **G.G.** – duke vepruar së bashku me bashkëkryerësin **B.G.**, dhe duke qenë në dijeni se sulmi ndaj **X.K.** do të mund të përfundonte me vrasjen e tij – ka kontribuar në mënyrë substanciale në aktin kriminal duke e vozitur veturën në të cilën qëndronte ulur si bashkudhëtar bashkëkryerësi i tij, duke ia bllokuar rrugën veturës e cila po vozitej nga viktima, duke e detyruar në këtë mënyrë viktimën të ndalej dhe duke ia mundësuar bashkëkryerësit të qëllojë me armë mbi të dhe duke e penguar viktimën në veprimin e tij për t’u mbrojtur. **X.K.** ka vdekur po atë ditë si rezultat i plagëve të shkaktuara nga goditja me plumbin e shkrepur nga bashkëkryerësi. Trupi gjykues ka konstatuar se **G.G.** ka qenë i aftë mentalisht dhe ka vepruar me dashje eventuale, se ka qenë në dijeni se sulmi ndaj viktimës do të mund të rezultonte në përleshje të armatosur duke rrezikuar kështu jetën e një a më shumë personash në

kohën e gjuajtjeve nga arma, pasi që disa njerëz kishin qenë duke ecur përgjatë rrugës së njëjtë pranë vendit të krimit. Megjithatë, trupi gjykues nuk e ka konstatuar të provuar faktin se viktimi ishte privuar nga jeta për shkak të hakmarrjes së paskrupullt apo për shkak të ndonjë motivi të ulët. **G.G.** është dënuar me dënimin prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh burgim duke e llogaritur në vuajtje të dënimit të shqiptuar edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe është urdhëruar ta kompensojë shumën prej 300 eurosh si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale;

**Duke vendosur rreth ankesës së avokatit mbrojtës Mahmut Halimi për të pandehurin G.G., të parashtruar më 27 gusht 2015, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, të marrë më 30 korrik 2015, P. Nr. 132/14**

*Pas shqyrtimit të ankesës së prokurorit të apelit të paraqitur më 13 tetor 2015;*

*Pas mbajtjes së seancës publike para kolegjit të apelit më 14 janar 2016;*

*Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 14 janar 2016;*

*Në pajtim me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tej në tekst “KPP”);*

*E merr këtë:*

---

## A K T G J Y K I M

---

- I. **Pranohet pjesërisht** ankesa e mbrojtësit Mahmut Halimi për të pandehurin G.G.. në pjesën ku kundërshtohet dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit.
- II. **Ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Mitrovicës Nr. P 132/14 i datës 30 korrik 2015 në pjesën mbi dënimin. Dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit G.G.. për veprën penale *vrasje e rëndë*, të kryer në bashkëkryerje, në pajtim me nenin 179, par. 1, nënpar. 1.5 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndryshohet si në vazhdim:  
I pandehuri G.G.. dënohet me dhjetë (10) vjet burgim. Koha e kaluar në paraburgim nga data 19 shtator 2014 do t'i llogaritet në vuajtje të dënimit.
- III. Sa iu përket pjesëve të tjera, **refuzohet si e pabazë** ankesa e mbrojtësit Mahmut Halimi për të pandehurin G.G.. ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar **vërtetohet**.

## A R S Y E T I M

### I. HISTORIKU I PROCEDURËS NË FJALË

Ngjarjet të cilat i kanë paraprirë rastit kriminal në fjalë kanë ndodhur më 22 mars 2013 në rrugën [...] në [...]. **G.G.** ka qenë duke e drejtuar automjetin e kuq Golf II, me bashkudhëtarin **B.G.** të ulur në ulësen e përparme me një pasagjer të tretë të ulur prapa në veturë. Me ta parë viktimën **X.K.** duke u afruar nga ana e kundërt e rrugës në një Mercedes ngjyrë të kaltër të mbyllët, **G.G.** e ndal veturën ndërsa **B.G.** del jashtë. **B.G.** ec në drejtim të Mercedesit përderisa **G.G.** e kthen Golfin në shiritin e majtë të rrugës dhe ia bllokoi rrugën Mercedesit. **B.G.** gjuan nga arma e tij në drejtim të **X.K.** dhe e plagos, pastaj kjo plagë plumbi më vonë po atë ditë ia shkaktoi vdekjen. **G.G.** menjëherë del nga Golfi dhe vrapon në drejtim të Mercedesit dhe e hap derën e parë të bashkudhëtarit. Në të njëjtën kohë, **X.K.** gjuan katër herë nga arma, duke e qëlluar me dy plumba **B.G.** dhe duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse.

Më 21 korrik 2014, gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit, ka lëshuar urdhër-arrestin për të pandehurin. Prokurori i ka pezulluar hetimet më 25 gusht 2014. I pandehuri është vetë-dorëzuar në polici më 19 shtator 2014 dhe që nga ajo datë është duke u mbajtur në paraburgim.

Më 14 nëntor 2014, prokuroria themelore e Mitrovicës ka ngritur aktakuzën PP. Nr. 10/14, me një sqarim të datës 8 dhjetor 2014, duke e akuzuar të pandehurin **G.G.** për vrasje të rëndë, në kundërshtim me nenin 179 (1.5) dhe (1.8) të KPRK-së.

Më 8 dhe më 23 dhjetor 2014 është mbajtur shqyrtimi fillestar.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë lëndë janë mbajtur më datat 30 qershor, më 2, 9, 24 dhe 28 korrik 2015, ndërsa këshillimet dhe votimi janë mbajtur më 28 korrik 2015. Më 30 korrik 2015, është shpallur aktgjykimi.

Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar **G.G.** më 13 gusht 2015, ndërsa prokurorit të EULEX-it më 12 gusht 2015. Më 27 gusht 2015 **G.G.**, përmes avokatit të tij mbrojtës, e ka apeluar aktgjykimin në fjalë.

Më 14 shtator 2015 prokurori i EULEX-it ka parashtruar përgjigjen në ankesë.

Lënda i është kaluar Gjykatës së Apelit për të vendosur rreth ankesës më datën 8 tetor 2015.

Më 13 tetor 2015, prokurori i apelit i shtetit ka parashtruar propozimin e vet.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit është mbajtur më 14 janar 2016, në praninë e të pandehurit **G.G.**, mbrojtësit të tij Mahmut Halimi, si dhe prokurorit të apelit.

Kolegji i apelit është këshilluar dhe ka votuar më datën 14 janar 2016.

## **II. PARASHTRESAT E PALËVE**

## A. Ankesa e G.G..t

**Avokati mbrojtës Mahmut Halimi** më 27 gusht 2015 ka parashtruar në kohë ankesën e datës 26 gusht 2015 për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit të procedurës penale,
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike,
- Shkeljes së ligjit penal dhe
- Vendimit për dënimin.

Avokati mbrojtës propozon që i akuzuari të lirohet nga akuza sepse nuk është provuar se ai ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar ose që të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda të kthehet mbrapa në rigjykim, ose që aktgjykimi të ndryshohet lidhur me cilësimin juridik të veprës penale si pjesëmarrje në rrahje, sipas nenit 190 paragrafi 1 të KPRK-së dhe dënimi të jetë sa më i butë i mundshëm.

Avokati mbrojtës pohon se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm për shkak se nuk përmban vërtetimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të cilat kërkohen për cilësimin e veprës penale si vrasje e rëndë. Elementi kualifikues përshkruhet vetëm në mënyrë të përgjithësuar pasi që personat jeta e të cilëve është vënë në rrezik nuk janë identifikuar. Po ashtu, edhe arsytimi i aktgjykimit nuk arrin t'i adresojë argumentet e paraqitura në fjalën përfundimtare të mbrojtjes të cilat përjashtojnë çfarëdo lloj përfshirje ose kontributi të të akuzuarit në vrasjen e viktimës. Këto shkelje esenciale të procedurës kërkojnë që Gjykata e Apelit *ex officio* ta anulojë aktgjykimin sikurse parashihet me nenin 402 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të KPPK-së.

Lidhur me vërtetimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, avokati mbrojtës pohon se arsytimi i aktgjykimit të shkallës së parë e shkel nenin 1 paragrafin 2 të KPPK-së i cili i përcakton rregullat për të garantuar se asnjë person i pafajshëm nuk duhet të dënohet dhe nenin 3 paragrafi 2 të KPPK-së, parimin *in dubio pro reo*. Avokati mbrojtës pohon se trupi gjykues e ka shikuar vetëm formalisht video-xhirimin e bërë nga kamera vrojtuese e vendosur aty, edhe pse trupi gjykues i referohet kësaj si “burim kryesor i informacioneve dhe vlerësimit për atë se çfarë ka ndodhur në rrugën ‘[...]’ në [...] më 22 mars kur ka ndodhur vepra penale në fjalë” ndërsa në arsytimin e aktgjykimit pohohet se trupi gjykues e ka shikuar disa herë video-xhirimin në fjalë dhe atë me shpejtësi normale dhe me lëvizje të ngadalësuar si dhe secilën pamje veç e veç. Avokati mbrojtës sjell një analizë të hollësishme të video-xhirit dhe pohon se trupi gjykues ka vepruar absolutisht në mënyrë të gabuar në disa pjesë, e në disa pjesë të tjera ka arritur në përfundime të pasakta dhe të palogjikshme në kundërshtim me atë që mund të shihet në video-xhirimin në fjalë. Ai pohon se konkluzionet e trupit gjykues janë po ashtu në kundërshtim me provat e tjera të tilla siç janë foto-dokumentet dhe të dhënat për vendin e ngjarjes dhe kjo qasje e vë në pikëpyetje objektivitetin e trupit gjykues dhe ka çuar deri tek vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike.

Shkeljet e procedurës penale dhe vërtetimi i gabueshëm i gjendjes faktike ka rezultuar në shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit. Mbrojtësi i konteston argumentet e trupit gjykues të parashtruara në pjesën e aktgjykimit me titullin “Cilësimi juridik”. Ai pretendon se kolegji ka gabuar kur e ka cilësuar veprën penale si vrasje të rëndë. Për një cilësim si ky, nuk mjafton rreziku abstrakt i rrezikimit të jetës së tjetrit apo i jetës së personave të tjerë, por duhet të ketë rrezik konkret të vërtetuar dhe kryerësi duhet ta ketë rrezikuar qëllimisht jetën e personit tjetër kur e ka kryer vrasjen. Kur rreziku në fjalë është abstrakt, siç është përdorimi i armës në vendin publik atëherë ky është element përbërës i veprës penale të rrezikimit të sigurisë së përgjithshme. Avokati mbrojtës i referohet praktikës juridike dhe e bashkëngjit një aktgjykim të Gjykatës së Apelit si dhe dy aktgjykime të Gjykatës Supreme për t’i mbështetur argumentet e veta.

Ankesa në fjalë gjithashtu e kundërshton arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me atë se cilat veprime të **G.G.** përbëjnë bashkëkryerjen, duke pohuar se gjykata ka dështuar në vërtetimin përtej dyshimit të arsyeshëm se

- I akuzuari e ka njohur viktimën apo automjetin e tij,
- Ai ka pasur marrëveshje paraprake me **B.G.** për ta sulmuar viktimën dhe se **B.** i kishte dhënë ndonjë shenjë në drejtim të veturës Golf që drejtohej nga **G.** – siç është konstatuar gabimisht nga kolegji bazuar në video-xhirimin në fjalë,
- I akuzuari e ka ditur se **B.** kishte armë me vete pasi që nuk është prezantuar asnjë provë që do ta konfirmonte këtë pohim.

Mbrojtësi pretendon se ajo çfarë është vërtetuar në mënyrë të pamohueshme nga provat është se:

- **G.** e kishte vërejtur se **B.** e kishte hapur derën e Mercedesit dhe e kishte filluar konfrontimin fizik me drejtuesin e veturës,
- Duke e ditur se **B.** ishte një person agresiv dhe jo-tolerant, ai kishte dalë nga vetura me qëllim të parandalimit të përkeqësimit të konfrontimit,
- **G.** nuk kishte pasur asgjë në duar, ai e kishte kapur derën e përparme të djathtë të Mercedesit. Pastaj kishin filluar të shtënat siç është konstatuar nga video-xhirimi që tregon se në atë moment fillojnë të ikin me vrap dy kalimtarë rasti që po ecnin aty pranë,
- **G.** e ka përkulur kokën brenda Mercedesit dhe pas dy sekondash është hedhur prapa nga shtypja e shkaktuar prej katër plumbave të shkrepur nga viktimja dhe pas kësaj **G.** ka filluar të ikë me vrap nga vendi i krimit.

Mbrojtësi konstaton se **G.G.** nuk kishte dhënë ndonjë kontribut esencial në vrasjen e viktimës dhe nuk e kishte pasur as më të voglin qëllim, bile as dashjen eventuale për shkaktimin e pasojave të veprimeve të cilat kanë ndodhur ditën kritike.

Ai pretendon se në rastin më të keq, veprimet e të akuzuarit kanë mundur të konsiderohen si pjesëmarrje në sulmin – rrahjen ndaj **X.K.**, prandaj vepra penale në fjalë duhet të cilësohet si pjesëmarrje në rrahje sipas nenit 190, par. 1 të KPRK-së, që ndëshkohet me një dënim shumë më

të lehtë. Ai i prezanton dy raste në ankesën e tij për t'i mbështetur argumentet e veta lidhur me cilësimin në fjalë.

Sa i përket dënimit, mbrojtësi pretendon se gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar një dënim të rreptë si rezultat i shkeljes së procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike, që ka rezultuar në shkeljen e ligjit penal. I akuzuari nuk ka pasur pushtet mbi veprimet e **B.G.** apo të **X.K.** dhe nuk ka treguar fare dashje për të kryer veprën penale, përkundrazi ai në të vërtetë e ka rrezikuar jetën për ta parandaluar të keqen e cila fatkeqësisht ka rezultuar me humbjen e dy jetëve. Për këtë arsye, i njëjti duhet të lirohet nga të gjitha akuzat apo në rastin më të keq ai duhet të marrë një dënim shumë të butë lidhur me veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje. Si rrethanë lehtësuese, gjykata duhet ta marrë parasysh moshën e tij të re, faktin se është i martuar dhe ka një fëmijë, se është mbajtës i familjes, i prindërve dhe i dy vëllezërve (apo motrave), se puna e tij është e domosdoshme për punimin e tokës dhe mirëmbajtjen e bagëtisë dhe se nuk ka të kaluar kriminale.

#### B. Përgjigjja e prokurorit në ankesë

**Prokurorja Lili Oprea** më 14 shtator 2015 ka parashtruar përgjigjen e saj në ankesën e mbrojtësit Mahmut Halimi. Ajo deklaron se pretendimet e bëra në ankesë janë të pabaza dhe se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është i vlefshëm dhe në përputhje me dispozitat e ligjit penal dhe të ligjit të procedurës penale. Gjukata e ka vlerësuar secilën provë të prezantuar gjatë shqyrtimit gjyqësor duke e përfshirë edhe video-xhirimin. Ajo i thekson dhe i analizon pjesët e caktuara të video-xhirit të cilat e bëjnë të pabazë pohimin e mbrojtjes dhe e mbështesin arsyetimin e aktgjykimit. Ajo qëndron pranë 'Cilësimit juridik' të aktgjykimit dhe fuqishëm e kundërshton këtë bazë ankimore. Veprimet në pjesën e video-xhirit që nuk kontestohet nga mbrojtësi nuk e përmbajnë asnjë element të veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje sipas nenit 190, par. 1 të KPRK-së. Për më tepër, mbrojtja nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 382, par. 3 të KPP-së. I pandehuri është shpallur fajtor me të drejtë për veprën penale të vrasjes së rëndë në bazë të nenit 179, par. 1, nënpar. 1.5, lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Faktorët lehtësues dhe ata rëndues janë vlerësuar ashtu si duhet. Prokurorja në fjalë i propozon Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën dhe ta vërtetojë aktgjykimin në fjalë.

#### C. Propozimi i prokurorit të apelit

**Prokurori i apelit Claudio Pala** në propozimin e tij të datës 13 tetor 2015 pajtohet me përgjigjen e dhënë nga prokurori dhe e konsideron të njëjtën si pjesë përbërëse të propozimit të tij. Ai është i mendimit se gjykata ka dhënë një analizë të mirëfilltë dhe të detajuar të provave relevante duke e përfshirë këtu edhe të gjitha provat e mundshme të cilat i mbështesin

argumentet e të pandehurit. Po ashtu, faktet mbi të cilat i pandehuri është shpallur fajtor janë vërtetuar drejt dhe cilësimi juridik që iu atribuohet fakteve nga ana e trupit gjykues është cilësim i saktë. Ai e thekson se vetë praktika gjyqësore që lidhet me ankesën në fjalë e thekson në mënyrë të qartë se aktet e të pandehurit do të kishin përbërë veprën penale të rrahjes vetëm sikur i pandehuri në fjalë të mos kishte qenë bashkëkryerës i vrasjes. Në rastin në fjalë, është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka vepruar me dashje jo të drejtpërdrejtë të privimit nga jeta të **X.K.t.** Po ashtu, e njëjta praktikë gjyqësore që lidhet me ankesën, në mënyrë të qartë e thekson se rrethana rënduese e rrezikimit të jetës së të tjerëve kërkon prova për një rrezik të tillë dhe në rastin në fjalë ky rrezik është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Nëse i kemi parasysh rrethanat të cilat e shoqërojnë rastin në fjalë, vendimi mbi dënimin është vendim i drejtë.

Prokurori i apelit propozon që të refuzohet ankesa si e pabazë dhe të konfirmohet aktgjykimi në tërësi.

### **III. GJETJET E KOLEGJIT TË APELIT**

#### **A. Kompetenca e kolegjit**

Në bazë të nenit 472 (1) të KPP-së, kolegji e ka shqyrtuar kompetencën e vet dhe pasi që nuk është ngritur asnjë kundërshtim nga palët, kolegji mjaftohet me sa vijon: në përputhje me Ligjin mbi gjykatat dhe me Ligjin mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë – Ligjin Nr. 03/L-053, të ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 de të sqaruar përmes Marrëveshjes në mes të shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton se EULEX-i ka juridiksion mbi lëndën në fjalë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur rreth çështjes në fjalë dhe atë në përbërje prej një gjyqtari të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve kosovarë të apelit.

#### **B. Pranueshmëria e ankesës**

Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 30 korrik 2015 ndërsa është finalizuar më 6 gusht 2015. Aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar **G.G.** më 13 gusht 2015. Ankesa është parashtruar më 27 gusht 2015, brenda afatit prej 15 ditësh në pajtim me nenin 380 (1) të KPP-së, nga personat e autorizuar, dhe përmban të gjitha informatat tjera të nevojshme në pajtim me nenin 376 *et seq* të KPP-së. Prandaj, ankesa në fjalë është e pranueshme.

#### **C. Gjetjet mbi çështjet meritore**

Kolegji i apelit do t'i diskutojë sfidat e ngritura në ankesën e të pandehurit **G.G.** sipas radhitjes së mëposhtme: (i) shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike; (iii) shkelja e ligjit penal; si dhe (iv) gabimi në vendimin mbi sanksionin penal.

## 1. Pretendimet për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë, kolegji i apelit konsideron se përkundrazi dispozitivi është i qartë, i logjikshëm dhe nuk është në kundërtënie me veten apo me arsyetimin. I njëjti ofron një përshkrim të qartë të fakteve vendimtare dhe i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara me nenin 370 (3) dhe (4) të KPP-së, lidhur me nenin 365 të KPP-së.

Mbrojtja nuk tregon se në bazë të cilës jurisprudencë dispozitivi është dashur t'i identifikojë në mënyrë specifike emrat e personave të rrezikuar, në pajtim me nenin 179 (1.5) të KPRK-së. Për më tepër, dispozitivi i referohet qartë rrezikut real dhe specifik për jetën e personave të tjerë, duke iu referuar dy personave të pranishëm brenda në qebaptore si dhe personave që kishin qenë duke ecur pranë vendit të krimit në rrugën [...].

Për këtë arsye, Gjykata e Apelit e refuzon pretendimin e mbrojtjes se gjendja faktike në dispozitiv nuk e mundëson cilësimin e veprës së vrasjes së rëndë në përputhje me nenin 179 (1.5) të KPRK-së.

Përderisa është e saktë se aktgjykimi i kundërshtuar nuk i referohet shprehimisht argumenteve të parashtruara nga mbrojtja në fjalën përfundimtare të bashkëngjitur procesverbalit të datës 28 korrik 2015, Gjykata e Apelit nuk është e bindur se Gjykata Themelore nuk i ka shqyrtuar këto argumente. Përveç kësaj, kolegji vëren se parashtrësit përfundimtare vetëm përmbajnë komente dhe interpretim të provave të prezantuara në gjykim, prova të cilat janë vlerësuar drejt dhe në tërësi, të cilave iu referohet trupi gjykues në aktgjykimin e kundërshtuar. Përveç kësaj, kolegji i apelit vëren se aktgjykimi i kundërshtuar po ashtu ka marrë parasysh edhe deklaratat e **G.G.** se nuk kishte qenë i përfshirë në asnjë mënyrë në aktet e **B.G.**

Kolegji i apelit e përkujton se është çështje e ndarë çështja nëse përfundimet e Gjykatës Themelore lidhur me vërtetimin e fakteve kanë qenë të drejta dhe të plota dhe kjo do të vlerësohet në pjesën në vazhdim të aktgjykimit.

## 2. Pretendimet për vërtetimin e gabueshëm dhe/ose jo të plotë të gjendjes faktike

Para vlerësimit të çështjeve meritore të argumenteve të prezantuara nga avokati mbrojtës, kolegji i apelit e përsërit standardin e shqyrtimit lidhur me gjetjet faktike të trupit gjykues. Është e qartë nga përkufizimet e “vërtetimit të gabueshëm të gjendjes faktike” dhe të “vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike”, të cilat jepen në nenin 386 të KPP-së se nuk është e mjaftueshme për të pandehurin që të demonstrojë vetëm lajthimin e pretenduar faktik apo vërtetimin jo të plotë faktik nga ana e trupit gjykues. Në vend të kësaj, duke e pasur parasysh se kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike të lidhet me një “fakt material”, i pandehuri gjithashtu duhet ta vërtetojë se vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike vërtet ka të bëjë me një fakt material, përkatësisht, një fakt me rëndësi të madhe për vendimin e marrë. Për më tepër, është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata



e Apelit duhet ta respektojë gjetjen faktike të trupit gjykues ngase trupi gjykues ka qenë në pozitën më të mirë për t'i vlerësuar provat. Gjykata e Apelit është e obliguar që të sigurohet se faktet të cilat janë me rëndësi për marrjen e vendimit të ligjshëm të vërtetohen në mënyrë objektive dhe të plotë.

Duke i pasur parasysh këto që u thanë më lart si dhe pas rishikimit të provave dhe analizave të këtyre provave të bëra nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit nuk është e bindur nga parashtrirat e të pandehurit **G.G.** Nga ana tjetër, gjykata është e bindur nga përfundimet dhe arsyetimi i Gjykatës Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar. Kolegji i apelit më tej është i bindur se trupi gjykues ka kryer një analizë të kujdesshme dhe të përpiktë të provave të administruara gjatë gjykimin dhe atë në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Në mënyrë më specifike, kolegji i apelit nuk e sheh asnjë kundërthënie apo mospërputhje të dukshme në mes të gjetjeve të trupit gjykues dhe provave të prezantuara në gjykim siç është video-xhirimi apo fotografitë dhe regjistrimet e bëra në vendin e krimit. Kolegji konstaton se mbrojtja nuk ka arritur ta mbështesë me prova apo ta identifikojë asnjë kundërthënie në këtë aspekt.

Pasi e kemi shikuar disa herë me kujdesin më të madh video-xhirimin në fjalë, duke e pasur parasysh në veçanti kohët specifike të cilave iu referohet mbrojtja, Gjykata e Apelit konstaton se ky video-xhirim nuk ka mundësi të shpie deri tek përfundimi se i pandehuri ishte përpjekur ta parkonte veturën në anën e majtë të rrugës. Përkundrazi, kolegji është i bindur se video-xhirimi tregon në mënyrë të pamohueshme se përderisa Golfi kishte pritur pak në anën e djathtë të rrugës, ai në mënyrë të befasishme kishte lëvizur në anën e djathtë në një përpjekje të qëllimshme për ta bllokuar Mercedesin që vozitej nga **X.K.** Kolegji i apelit nuk e sheh asnjë gabim në vlerësimin e bërë nga trupi gjykues kur kemi të bëjmë me provat në këtë aspekt.

Për më tepër, derisa kolegji pajtohet me mbrojtjen se cilësia e këtij video-xhirimi nuk është e mjaftueshme sa për ta vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se **B.G.** i kishte dhënë shenjë **G.G.** që t'ia bllokonte rrugën Mercedesit, kolegji konstaton se, pavarësisht nga fakti në fjalë, video-xhirimi në mënyrë të pakontestueshme zbulon se sulmi kundër viktimës **X.K.** ka qenë i planifikuar në mes të këtyre tre bashkëkryerësve dhe se veprimet e **G.G.** kanë qenë të bashkërenduara dhe të qëllimshme. Ngjashëm me këtë, përderisa video-xhirimi nuk e mundëson që ta konfirmojmë nëse **B.G.** tashmë e kishte revolen në dorë kur kishte dalë nga Golfi dhe po ecte në drejtim të Mercedesit, Gjykata e Apelit konstaton se i vetmi konkluzion i arsyeshëm nga rrjedha e veprimeve të **G.G.** siç tregohet në video-xhirim është se ai nuk ka mundur ta injorojë faktin se **B.G.** e kishte revolen dhe po mëtonte ta sulmonte **X.K.**

Si konkluzion, kolegji i apelit është i bindur se Gjykata Themelore në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se argumentet e ngritura në ankesë në emër të **G.G.** nuk i zbehin gjetjet në fjalë.

### 3. Pretendimet rreth shkeljeve të ligjit penal

Sa i takon argumentit të mbrojtjes se Gjykata Themelore ka gabuar në cilësimin juridik të veprës penale si vrasje e rëndë për rrezikimin e jetës së personave tjerë në pajtim me nenin 179 (1.5) të KPRK-së, Gjykata e Apelit konstaton se, ndryshe nga pretendimi i mbrojtjes, rreziku i rrezikimit të jetës së personave të tjerë nuk ka qenë një rrezik abstrakt por një rrezik real dhe specifik. Në këtë drejtim, ajo vëren se, siç është theksuar nga mbrojtja, video-xhirimi tregon njerëz në rrugë që fillojnë të ikin me vrap, nga frika për shkak të gjuajtjeve me armë. Përveç kësaj, njerëzit në qebaptore ishin të detyruar të ndërmarrin veprime të menjëhershme për ta mbrojtur veten nga zjarri i armëve.

Një rishikim i kujdesshëm i jurisprudencës, të cilit i referohet mbrojtja në atë aspekt, nuk ia lejon Gjykatës së Apelit që të konkludojë se cilado situatë si kjo mund të aplikohet edhe në rrethanat e rastit në fjalë.

Në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR nr. 321/2014 të datës 28 tetor 2014, Gjykata e Apelit ka konstatuar se, përderisa kishte pasur njerëz të tjerë të pranishëm në kafene në kohën kur ndodhi sulmi, nuk është provuar se jeta e tyre ka qenë në rrezik pasi që ka marrë parasysh faktin se revolja ka mundur të mbahet nën kontroll, duke e shmangur kështu rrezikun konkret për të tjerët. Po ashtu është konstatuar se ka pasur vetëm dy gjuajtje nga arma dhe se nga provat nuk është pasqyruar se plumbi i dytë ka mundur ta qëllojë dikë tjetër përveç palës së dëmtuar.

Përderisa në rastin në fjalë, kolegji i apelit e përsërit se është vërtetuar me prova se ka pasur së paku gjashtë gjuajtje nga arma dhe se trajektorja e disa prej plumbave të shkrepur ka qenë trajektore e çrregullt, pasi që personat të cilët gjuanin nuk ishin më nën kontroll të armëve të tyre. Përveç kësaj, kolegji është i bindur se rreziku në fjalë ka qenë real dhe konkret, duke pasur parasysh se siç është treguar me provat e prezantuara, njerëzit të cilin ishin duke ecur filluan të ikin me vrap nga vendi i krimit, dhe pasi që njerëzit brenda në qebaptore ishin detyruar ose të ishin shtrirë përtokë ose të fshihen pas një shtylle për ta mbrojtur veten.

Në aktvendimin e Gjykatës Supreme AP nr. 344/2011 të datës 8 mars 2012, ishte konstatuar se, në bazë të shkresave të lëndës, një plumb e kishte qëlluar palën e dëmtuar në lokalin e tij, përderisa nuk kishte persona të tjerë të pranishëm në të, ishte qëlluar edhe dritarja e një lokali të zbrazët dhe në atë moment nuk kishte pasur kalimtar rasti. Prandaj, Gjykata Supreme kishte konstatuar se nuk kishte pasur ndonjë rrezik real dhe specifik, dhe si rezultat i kësaj, të kaluarit nuk e kishin rrezikuar jetën e askujt.

Në rastin në fjalë, përkundrazi me prova vërtetohet se disa njerëz kanë qenë duke ecur në rrugë afër vendit të krimit në kohën e sulmit, dhe se ka pasur njerëz të pranishëm brenda në qebaptore kur një plumb kishte depërtuar në dyqan dhe e kishte goditur frigoriferin. Për këtë arsye, sipas pikëpamjes së kolegjit të apelit, rreziku në fjalë ka qenë real dhe specifik si dhe rrethanat e rasteve në fjalë dallojnë dukshëm mes vete.

Kolegji konsideron se mbrojtja po ashtu nuk arrin të tregojë se me çfarë jurisprudence kërkohet identifikimi specifik i personave të rrezikuar. Sidoqoftë, kolegji vëren se dy persona që kanë qenë të pranishëm në qebaptoren në fjalë janë identifikuar dhe i kanë dhënë dëshmitë e tyre në gjykatë e këta janë B.Q. dhe A.M..

Për më tepër, kolegji i apelit është i bindur se bashkëkryerja sipas nenit 31 të KPRK-së po ashtu vërtetohet ashtu si duhet pasi që veprimet e të pandehurit demonstronjë kontributin e tij substancial në kryerjen e krimit në fjalë. Vërtet, veprimet e tija për bllokimin e Mercedesit dhe ngutja në drejtim të derës së bashkudhëtarit të Mercedesit me qëllim të pengimit të **X.K.** në ndërmarrjen e veprimeve mbrojtëse kanë qenë veprime qendrore për kryerjen e veprës penale në fjalë nga bashkëkryerësi **B.G.**. Kolegji më tutje konstaton se pa kontributin esencial të **G.G.**, **B.G.** nuk do të kishte mundur ta kryente veprën penale i vetëm.

Gjykata e Apelit është e mendimit se fakti nëse **G.G.** e kishte njohur viktimën ose jo apo nëse kishte pasur marrëveshje paraprake me **B.G.** për ta vrarë **X.K.** nuk është me rëndësi për cilësimin juridik të veprës penale dhe për konstatimin nëse ai kishte dashje eventuale apo jo. Ngjashëm me këtë, është e parëndësishme që **G.G.** nuk ka pasur asgjë në duar. Ky element nuk kontestohet dhe nuk është kusht për cilësimin juridik të veprës penale.

Kolegji plotësisht pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se **G.G.** ka qenë në dijeni se ky veprim i tij, përkatësisht ngasja e Golfit në drejtim të Mercedesit dhe të bllokuarit e rrugës, si dhe pengimi i **X.K.** për ta mbrojtur veten, ka mundur të çonte në vrasjen e **X.K.** prandaj ky veprim i tij ka qenë zgjedhje e tij e vetëdijshme. Sipas pikëpamjes së Gjykatës së Apelit, provat, në veçanti video-xhirimi, në mënyrë të pamohueshme e pasqyrojnë planifikimin dhe bashkërendimin e veprimeve të të pandehurit me aktet e bashkëkryerësve të tjerë në sulmin e kryer.

Duke iu kthyer jurisprudence së referuar nga avokati mbrojtës në ankesën e tij në të cilën ai gjoja e mbështet ri-cilësimin e veprës penale si pjesëmarrje në rrahje sipas nenit 190 (1) të KPRK-së, kolegji i apelit nuk është i bindur se mund të aplikohet ndonjë prej këtyre rasteve në rastin në fjalë pasi që secili rast dallon nga tjetri.

Në aktgjykimin e Gjykatës Supreme AP nr. 45/2010 të datës 28 tetor 2010, Gjykata Supreme kishte konstatuar se sulmuesi i cili nuk është bashkëkryerës në vrasje apo në lëndim të rëndë trupor duhet të mbahet përgjegjës për veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje. Më tutje kishte konstatuar se vepra penale e pjesëmarrjes në rrahje përfshin "*pjesëmarrjen në konfliktin e ndërsjellë fizik në mes të disa personave*".

Megjithatë, në rastin në fjalë, Gjykata Themelore me të drejtë ka konstatuar se është vërtetuar me prova se veprimet e **G.G.** përbëjnë bashkëkryerjen. Përveç kësaj, pjesëmarrja e tij në veprën penale nuk përbën *konflikt fizik* me viktimën **X.K.** dhe me **B.G.** dhe se nuk është provuar se ka pasur ndonjë kontakt fizik me viktimën në fjalë.

Në fund, në aktvendimet e kantonit të Bihaqit në lëndën KTZ 155/08, ishte konstatuar se, pasi që pala e dëmtuar ishte duarthatë dhe nuk ishte në pozitë për t'i rezistuar të pandehurit të dytë i cili ishte i armatosur me një revole “të gatshme për të gjuajtur me të”, për këtë arsye, veprimi i të pandehurit, duke e sulmuar viktimën me karrige, nuk ka mundur të konsiderohet si ndihmë në kryerjen e veprës vrasje në tentativë.

Në rastin në fjalë, përkundrazi, vlen të përmendet se viktima **X.K.**, ka qenë e armatosur dhe në pozitë për t'i rezistuar sulmit, siç demonstron me prova pasi që ka qenë në gjendje të përgjigjet me gjuajtje nga arma e zjarrit dhe ta plagosë për vdekje **B.G.**. Sidoqoftë, kolegji vëren se në këtë rast kemi të bëjmë me ndihmë në vrasje në tentativë dhe jo bashkëkryerje, prandaj çfarëdo krahasimi duhet të konsiderohet i parëndësishëm.

Duke i pasur parasysh këto që u thanë më lart, Gjykata e Apelit e refuzon parashtresën e mbrojtjes se vepra penale duhet të ri-cilësohet si pjesëmarrje në rrahje, sipas nenit 190 (1) të KPRK-së.

#### 4. Pretendimet lidhur me vendimin mbi sanksionin penal

Sa i përket vendimit mbi dënimin, kolegji i apelit me kujdes ka shqyrtuar rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të vërtetuara nga Gjykata Themelore si dhe kundërshtimet e ngritura në këtë drejtim në ankesën e të pandehurit.

Duke e pasur parasysh parimin e proporcionalitetit të përcaktuar në nenin 33 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjatë caktimit të dënimit brenda kufirit ligjor, sanksioni nuk mund ta tejkalojë fajësinë e kryerësit, ose të jetë më i ulët sesa sanksioni i nevojshëm për ta siguruar parandalimin individual dhe atë të përgjithshëm. Llogaritja e tij duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të përmendura në nenin 74 të KPRK-së.

Kolegji e pranon argumentin e mbrojtjes se Gjykata Themelore, kur ka konstatuar se e vetmja rrethanë lehtësuese ka qenë arritja e pajtimit në mes të familjeve G. dhe K., nuk e ka marrë parasysh gjendjen familjare të të pandehurit, pra faktin se ai është i martuar dhe baba i një fëmije dhe mbajtësi kryesor i familjes, duke i përfshirë këtu edhe prindërit e tij, si dhe faktin që nuk ka qenë i dënuar më herët. Gjykata e Apelit është e pikëpamjes se këta faktorë është dashur të jenë marrë parasysh si rrethana lehtësuese. Megjithatë, Gjykata e Apelit e refuzon pretendimin e avokatit mbrojtës se **G.G.** e kishte rrezikuar jetën e vet duke u përpjekur ta parandalonte më të keqen.

Kolegji i apelit konstaton se, përderisa i pandehuri ka qenë bashkëkryerës dhe përderisa në esencë i njëjti ka kontribuar në kryerjen e veprës penale, ndërsa derisa neni 31 i KPRK-së përcakton që bashkëkryerësit në një vepër penale duhet të mbahen përgjegjës dhe të dënohen ashtu siç përcaktohet për atë vepër penale, i njëjti nuk ka qenë kryerësi kryesor dhe nuk ka qenë ai i cili e ka tërhequr këmbëzën e armës. Për këtë arsye, kolegji konstaton se shkalla e

pjesëmarrjes së **G.G.** në veprën penale në fjalë nuk mund të përbëjë rrethanë rënduese në bazë të nenit 74 të KPRK-së.

Për më tepër, kolegji konstaton *ex officio* se fakti që i pandehuri është dorëzuar në mënyrë vullnetare përbën rrethanë rënduese në bazë të nenit 74 (3.8) të KPRK-së. Ky fakt është dashur të merret parasysh kur Gjykata Themelore e ka caktuar dënimin në fjalë.

Duke i pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të vërtetuara drejt nga Gjykata Themelore dhe duke i marrë parasysh si duhet rrethanat shtesë lehtësuese lidhur me gjendjen familjare të të pandehurit, mungesën e dënimit të mëhershëm për ndonjë veprë penale, dorëzimin e tij në baza vullnetare dhe duke e pasur parasysh dënimin minimal të përcaktuar për veprën vrasje e rëndë, i cili është dhjetë (10) vjet burgim në bazë të nenit 179 (1) të KPRK-së, kolegji konstaton se dënimi prej gjithsej pesëmbëdhjetë vjetësh burgim, i shqiptuar nga Gjykata Themelore, është dënim jo-proporcional. Gjykata e Apelit konstaton se dënimi prej dhjetë (10) vjetësh burgim do ta pasqyronte dënimin e duhur duke i pasur parasysh rrethanat e rastit në fjalë. Gjykata e Apelit, prandaj, për këtë arsye e ndryshon aktgjykimin e kundërshtuar në pjesën e vendimit mbi dënimin.

#### D. Përfundim

Kolegji i apelit, për arsyet e shtjelluara më lart, në mënyrë të pjesshme e pranon ankesën e mbrojtjes, e ndryshon pjesën dënuese të aktgjyimit të kundërshtuar dhe të pandehurit **G.G.** i shqipton dënimin prej dhjetë (10) vjetësh burgim. Gjykata e Apelit e refuzon pjesën e mbetur të ankesës në fjalë dhe e vërteton pjesën tjetër të aktgjyimit të kundërshtuar.

*Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më 4 shkurt 2016.*

Kryetarja e kolegjit,

\_\_\_\_\_

Hajnalka Veronika Karpati

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit,

Anëtari i kolegjit,

\_\_\_\_\_  
Driton Muharremi,  
Gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

\_\_\_\_\_  
Abdullah Ahmeti,  
Gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

Procesmbajtëse,

\_\_\_\_\_  
Anne-Gaëlle Denier  
Zyrtare ligjore e EULEX-it

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR 474/15**  
**14.01.2016**